

Bashkim Aljiji, PhD¹

UDC: 28-23:172.4
28-768-277

DILEMA TË PAQES NË TEKSTE FETARE

ДИЛЕМИ НА МИРОТ ВО ВЕРСКИ ТЕКСТОВИ

PEACE DILEMMAS IN RELIGIOUS TEXTS

Abstract

In this paper, the peaceful character of the Islamic religion is argued by answering some of the dilemmas raised by different parties regarding the peaceful character of Islam.

This paper presents some of the dilemmas that dispute the peaceful character of Islam, explains the point of view of the representatives of these dilemmas as well as their interpretation of certain religious texts, which leads to the conclusion that Islam is not a religion of peace, but a religion which promotes intolerance and violence.

The dilemmas regarding the peaceful character of the Islamic religion, which are presented in this paper, refer mainly to religious texts, both in the Qur'an and in the prophetic tradition, which texts are taken as arguments by the challengers of the peaceful character of the Islamic religion.

In this paper, religious texts are analyzed which are evidenced as arguments that the Islamic religion is not peaceful, their true meaning is explained, the reasons and circumstances in which such texts were said are clarified, it is proved that these texts have nothing in common with the promotion of violence and intolerance, and it is argued that the unfair and non-comprehensive interpretation of these texts has led to their labeling as texts that speak of the non-peaceful character of Islam, rather than the texts themselves.

In this paper, the notion of "jihad" is treated in particular, the exact meaning of this notion in the linguistic aspect and in the religious context, as well as the theory that this notion constitutes the basic dilemma of denying the peaceful character of Islam, is denied.

Keywords: *Dilemma, peace, religious texts, Islam, verses (ayat), hadiths, context.*

¹ Autori është doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim dhe teolog.

Hyrje

Islami në qenësinë e vet paraqet mesazh për njerëzimin, andaj pikërisht ky thelb i doktrinës islame e determinon komunikimin me njerëzit, i cili nuk mund të gjejë vend, përpos nëse është paqësor, konstruktiv dhe progresiv. Po ashtu, një element tjetër kyç i konceptit islam si fe që i drejtohet njeriut, është universaliteti, gjegjësisht destinimi i tij për të gjithë njerëzit pa dallim gjuhe, etnie dhe rase, si dhe shkon përtej kufijve kohor, ashtu që i drejtohet njeriut të çdo periudhe historike derisa të ekzistojë jeta dhe bota. E gjithë kjo konsiston në platformën paqësore dhe koekzistuese për formësimin e marrëdhënieve mes njerëzve, ngase vetëm në këtë mënyrë mund të promovohen mësimet e fesë islame me një doktrinë të këtillë.

Mirëpo, edhe përsikaj kësaj, paqja si koncept bazë i Islamit është kontestuar nga palë të ndryshme të cilat gjykimet e tyre i kanë ndërtuar mbi veprimet e disa individëve dhe grupimeve të cilët kanë përkatësi islame, por jo mbi analiza të mirëfillta të mësimave islame nga burimet e tyre autoritative.

Në fakt, hasim jo rrallë herë palë dhe individë të cilët thirren në disa ajete të Kuranit apo thënie të të Dërguarit të Zotit për ta argumentuar pretendimin e tyre se Islami nuk e promovon paqen, por e promovon luftën si mekanizëm më të sigurt për t'i detyruar njerëzit t'i pranojnë mësimet e tij dhe t'u sigurojë pjesëtarëve të tij dominim mbi njerëzit e tjerë, dhe për këtë qëllim, këtë luftë, e ka cilësuar si "luftë në rrugë të Allahut", apo luftë të shenjtë.

Nisur nga kjo, është e një rëndësie të veçantë të trajtohen dilemat e këtilla në lidhje me tekste fetare në kontekst të paqes, dhe të jepen përgjigje ndaj këtyre dilemave të tyre në lidhje me tekste fetare në dritë të burimeve autoritative të Islamit.

1. Kaptina Et Teube, kaptinë e luftës e jo paqes

Dilema më e dukshme e tyre lidhet me një kaptinë të Kuranit, gjegjësisht kaptinë Et Teube, të cilën kaptinë, për shkak përmbajtjes së disa ajeteve të saj, e konsiderojnë kaptinë të luftës. Sipas atyre që e kontestojnë karakterin paqësor të Islamit, pikërisht kaptina Et Teube, është shembull më eklatant i karakterit jopaqësor të Islamit, e më pas, në veçanti, u qasen edhe disa ajeteve të kësaj kaptine, për ta mbështetur tezën e tyre.

Kaptina Et Teube flet për luftë, por jo si prioritet i komunitetit musliman dhe përcaktim i fesë islame për pjesëtarët e saj në raport me komunitetet e tjera dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi, por si përgjigje ndaj tradhtive, ndërkëmbëzave, rrezikimit serioz të ekzistencës së muslimanëve, jo respektimit të të drejtave të muslimanëve për ta përzgjedhur fenë të cilës duan t'i përkasin, privimin e tyre nga liritë themelore, ndalimin e fjalës së lirë dhe lirinë e mendimit, si dhe për shkak të sulmit të tyre kundër muslimanëve. Për këtë, siç shprehet edhe Muhamed Gazali, ishte domosdo fillimi i një lufte të

ashpër me kriminelët e tillë - si përgjigje -, dhe t'u bëhet me dije se ata do të përballen me shtetin e ri të formuar islam, i cili nuk do të rrijë duarkryq kundrejt tyre. Ky është kuptimi i vërtetë i kaptinës Et Teube, kaptinë e cila u shpall nga ana e Zotit të Madhëruar kundër forcave tradhtare politeiste dhe kriminale... Urdhri për luftë në kaptinën Et Teube nuk ka të bëjë me popullin që është i matur apo objektiv (neutral), por ka të bëjë me një popull, zemra e të cilit është mizore, dora e të cilit na sjell dëm.²

Në këtë drejtim, një analizë të shkëlqyeshme ka bërë edhe Dr. Mustafa Zejd në librin e tij "En Nas'hu fil Kur'anil kerim" (Abrogimi në Kur'anin fisnik), ku, në lidhje me këto ajete, shënon:

"Idhujtarët për të cilët flet ajeti i shpatës, janë një grup i posaçëm i idhujtarëve të cilët kanë pasur marrëveshje me të Dërguarin e Zotit, dhe ata e kanë thyer këtë marrëveshje, si dhe u kanë ndihmuar armiqve të të Dërguarit të Zotit kundër tij. Idhujtarët të cilët kanë qenë armiq të Islamit dhe të të Dërguarit të Zotit, nuk kanë qenë të gjithë idhujtarët. Këtë e vërtetojmë me fjalët e të Lartmadhërishtit para ajetit të shpatës: **"Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni lidhur marrëveshje, e të cilët nuk janë shmangur asgjë dhe nuk e kanë ndihmuar askënd kundër jush, pra, edhe ju përmbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar. S'ka dyshim se Allahu i do të devotshmit"**.³ Po ashtu, këtë e vërtetojnë edhe hadithet e shumta të cilat flasin se kur i Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, e dërgoi Aliun, Zoti e mëshiroftë - që ta kumtojë se marrëveshja me idhujtarët është shkëputur, e urdhëroi që të kumtojë, po ashtu, se "ata që kanë marrëveshje me të Dërguarin e Zotit, marrëveshja vlen deri në afatin e përcaktuar."⁴

2. Sulmi vjetor kundër jomuslimanëve

Në drejtim të kontestimit të përcaktimit të Islamit për paqe dhe marrëdhënie të mira me njerëzit e besimeve të tjera, disa janë thirrur në një qëndrim të juristëve klasikë islamë, e që është përcjellë edhe nga disa juristë tjerë të mëvonshëm, se udhëheqësi i muslimanëve, gjegjësisht kryetari i shtetit, sipas fjalorit të sotëm, obligohet të dërgojë në vendet ku jetojnë jomuslimanët, për çdo vit, ushtri, e cila do të bëjë xhihad (do të konfrontohet ushtarakisht) me jomuslimanët, dhe prej tyre do të pranojë vetëm dy gjëra: Ose besimin, ose tatimin?⁵

Duhet theksuar se kjo çështje është trajtuar nga juristët klasikë islamë, por trajtimi i kësaj çështje nuk ka qenë rezultat i ekzistimit të teksteve fetare që e obligojnë apo porosisin një veprim të tillë, dhe as që ka qenë pozicioni i

² Gazali, Muhamed, *Komenti tematik i Kur'anit famëllartë*, Logos-A, Shkup, 2007, f.184, f.27.

³ Et Teube: 4.

⁴ Cituar sipas: El Karadavi, Jusuf, *Fetava muasire*, botimi i parë, Darul kalem, Kajro-Kuvajt, 2009, vëll. IV, f.45-48.

⁵ Po aty, f.171.

pranuar me konsensus prej dijetarëve islamë, por ka qenë rezultat i realitetit ekzistues në kohën e tyre, kur shteti islam ka qenë i rrezikuar nga shtetet e tjera me të cilat ka qenë i kufizuar. Bile, edhe në atë kohë kur ka dominuar mentaliteti i luftës, ka pasur dijetarë që megjithatë, këtë luftë nuk e kanë konsideruar të obligueshme, por thjeshtë vullnetare, jo të obligueshme. Bile, disa prej shokëve të të Dërguarit të Zotit dhe pasardhësve të tyre (tabi'inëve), si: Abdullah ibn Omeri, pastaj nga tabi'inët Amër ibn Dinari, si dhe nga juristët Ibn Shubrume dhe Eth Theuriju, këtë luftë nuk e shihnin në asnjë rast të obligueshme, por vullnetare (nafi).⁶

Marrëdhëniet ndërkombëtare të asaj kohe, kanë qenë të theksuara nga luftërat, ashtu që shtetet kanë pasur pretendime territoriale mes vete, i forti i ka imponuar nënshtrim më të dobët, qoftë me dorëzim pa luftë dhe pranim të autoritetit të tij, apo nënshtrim me luftë. Nisur nga kjo, juristët klasikë islamë kanë diskutuar për çështjen në fjalë. Kjo luftë që e kanë trajtuar juristët klasikë islamë, “në fakt, është një lloj e asaj lufte që sot quhet “luftë preventive”. Juristët islamë të cilët e kanë mbajtur këtë qëndrim, kanë qenë nën ndikimin e realitetit ekzistues në kohën e tyre, kur muslimanët i kanë sulmuar kohë pas kohe bizantinët, për t’u treguar se janë të fuqishëm dhe se nuk do të duhej të guxojnë t’i shkelin kufijtë e shtetit islam.”⁷

Ky pretendim nuk paraqet parim fetar, nuk është qëndrim konsensual i dijetarëve, dhe as që është produkt i teksteve fetare, por është rezultat i pikëpamjeve që i ka imponuar realiteti i raporteve mes shteteve në kohën përkatëse.

3. Imponimi i besimit me fuqi, dhe mos tolerimi i besimeve tjera

Në vazhden e kontestimeve të karakterit paqësor të Islamit dhe teksteve fetare, nënvizohen edhe disa hadithe të cilat tekstualisht shprehen se i Dërguari i Zotit është urdhëruar t’i luftojë njerëzit derisa të thonë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut”. E kur ta deklarojnë këtë, atëherë e kanë siguruar jetën dhe pasurinë e tyre, gjegjësisht nuk janë objekt i luftimit dhe humbjes së pasurisë, si rezultat i ngadhënjimit mbi ta në luftë. Ja një nga këto hadithe që merret si argument nga kontestuesit e karakterit paqësor të Islamit: Është transmetuar prej Ebu Hurejres se i Dërguari i Zotit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: *“Jam urdhëruar t’i luftojë njerëzit derisa të thonë: Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, e kush thotë nuk ka zot tjetër përveç Allahut, e ka të mbrojtur prej meje pasurinë dhe veten e tij, me përjashtim nëse drejtësia kërkon që të jep përgjegjësi, ndërsa llogaria e tij do të jetë tek Allahu”*.⁸

⁶ Po aty, f.180.

⁷ Po aty, f.180.

⁸ Hadithin e ka trasmetuar Muslimi në *Sahih-un* e tij, libri i besimit, kapitulli: Urdhri për luftimin e njerëzve derisa të thonë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i dërguar i Allahut...”. Shih: En Nevevij, Jahja ibn Sheref, *El Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslim ibn El Haxhxhaxh*, botimi i parë, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1995, vëll.I, f.187, hadithi nr.33.

Hadithi: “Jam urdhëruar t’i luftojë njerëzit derisa të thonë: La ilahe il-la Allah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), e kush thotë La ilahe il-la Allah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut)...” nuk përçon mesazh të jotolerancës ndaj pjesëtarëve të besimeve tjera, as që nxit vrasjen e tyre apo luftimin e tyre. Ky hadith nuk thërret që t’u imponohet njerëzve feja me fuqi, ngase atëherë do të binte në kundërshtim me vetë Kuranit, i cili ndalon që feja të imponohet me dhunë. Në Kuran qëndron qartë: **“Në fe nuk ka detyrim...”**⁹ Po ashtu, edhe vetë i Dërguari i Zotit, ka jetuar në Medine ku ka pasur edhe hebrenj, po ka ardhur në kontakt edhe me të krishterë dhe nuk u ka shpallur luftë atyre që t’ua ndërrojë fenë. Në të kundërtën, kur erdhi në Medine pasi u shpërngul nga Meka, bëri marrëveshje me hebrenjtë, edhe pse ata nuk dëshmonin se ai është i dërguari i Zotit. Nocioni “njerëz” i përmendur në hadith, në asnjë mënyrë nuk aludon në tërë njerëzimin, por në një grup të caktuar të cilët kanë qenë në luftë me komunitetin musliman në kohën e të Dërguarit të Zotit. Luftimi u referohet atyre të cilët i kanë luftuar muslimanët, e jo çdo pale që nuk ka qenë në fenë islame. Njya shquese “El” e cila gjendet te nocioni “En-Nas” (njerëzit), në këtë hadith, nuk ka kuptim të përfshirjes së gjithë llojit të njerëzve, por ka kuptim të palës që është objekt bisede, e ata janë ata që kanë qenë në luftë me muslimanët, dhe kjo palë e veçantë e cila ka qenë objekt bisede, kanë qenë idhujtarët e Mekes të cilët i luftonin muslimanët në të gjitha format, dhe ashtu siç shprehet edhe Kurani: **“Ata nuk respektojnë te asnjë besimtarë as farefisninë as marrëveshjen; si të tillë ata janë përdhunues”**.¹⁰

Ahmed Omer Hashim, ish-rektor i Universitetit të njohur të Al-Az’harit dhe anëtar i Shoqatës së Dijetarëve të mëdhenj në Egjipt, thotë: “Njerëzit të cilët përmenden këtu, janë një grup i caktuar të cilët e kanë luftuar të Dërguarin e Zotit dhe muslimanët, të cilët i kanë ndaluar njerëzit ta pranojnë Islamin. Pra, këta kanë qenë idhujtarët”.¹¹ Po ashtu, Dr. Ahmed Et-Tajjib, i cili mban pozitën e “Shejhu-l-Az’har”, thotë: “Fjala ‘njerëz’ në hadith, nuk aludon në të gjithë njerëzit dhe as në të gjithë globin, por aludon në njerëz të caktuar dhe palë të veçantë, ngase ‘el’ te fjala ‘En-Nas’ është për palë të përmendur (lil ahd), dhe kjo palë kanë qenë idhujtarët e Mekes të cilët i dëbuan muslimanët nga shtëpitë e tyre në Meke, e luftuan të Dërguarin e Zotit, i shkelën marrëveshjet dhe nuk respektuan as farefisni dhe as marrëveshje. Ky është kuptimi i saktë i hadithit, ndërkaq është për të ardhur keq që disa e kanë kuptuar hadithin se e obligon përdorimin e forcës për përhapjen e fesë. Ky është kuptim i gabuar dhe flet se ai që mendon kështu, nuk e njeh gjuhën arabe.”¹²

⁹ El-Bekare: 256.

¹⁰ Et-Teube: 10 .

¹¹ Burimi: Abdurrahim, Muhamed Sabrij dhe Feuzij, Neda, “Umirtu en ukatil”. Në dispozicion: <https://www.elbalad.news/1341292> (marrë më 16.01.2022).

¹² Hixhazi, Seid dhe Isa, AbdulVehab, “Umirtu en ukatile en nas, hakkun havvelehu el irhabijjune ila el batil”. Në dispozicion:

<https://m.elwatannews.com/news/details/3840678?t=mpush> (marrë më 01.07.2023).

4. Debati rreth xhihadit

Koncepti i paqes në Islam u përball me debat të ashpër nga kontestuesit e tij për shkak të institucionit të xhihadit, i cili sipas kontestuesve të karakterit paqësor të Islamit si fe, nuk përputhet me paqen. Bile, “Xhihadi”, mund të thuhet se paraqet kryefjalën e kontestuesve të karakterit paqësor të Islamit. “Xhihadi” u cilësua nga shumë palë si inspirim për terrorizëm. Sipas analistit francez Olivier Roy (Olivier Roy), debati për “Xhihad-in” u shtrua që nga viti 1990, kur erdhi deri te radikalizimi politik i neofundamentalistëve, prej të cilëve një pjesë u shndërruan në xhihadistë.¹³

Mirëpo, përkufizimi i këtillë i xhihadit, a është i drejtë, dhe a thua xhihadi mund të identifikohet me terrorizmin?

Përkufizimi i xhihadit vetëm si luftë e cila bëhet në emër të fesë, për përhapjen e saj dhe për kthimin e gjithë njerëzve në fenë islame, është jo i saktë. Duke folur për kuptimin e nocionit “xhihad”, dijetari Jusuf El Karadavi nënvizon se të kuptuarit e xhihadit, vetëm si “rreëmbim i shpatës kundër armikut”, apo “thjeshtë si luftë”, nga ana e disa muslimanëve, si dhe si “luftë kundër mbarë njerëzimit pa bërë dallime, me qëllim që të detyrohen ta pranojnë fenë islame apo t’i nënshtrohen pushtetit të muslimanëve”, është gabim, pasi xhihadi ka kuptim shumë më të gjerë se sa thjeshtë vetëm luftë.¹⁴

Që të kemi një pasqyrë të drejtë të kuptimit të xhihadit, duhet që ky nocion të analizohet nga aspekti gjuhësor dhe fetar.

Në aspektin gjuhësor, rrënja e fjalës “xhihad” është “xhehd”, që d.m.th., mund, orvatje, t’i përballosh diçkahi dhe të mbetesh i uritur. Pra, në aspektin gjuhësor, “xhihadi” konsiston në mund dhe orvatje, ku bën pjesë edhe orvatja e njeriut për t’i mundur epshet dhe gjithë atë që e prish ekuilibrin ndërmjet botës shpirtërore dhe materiale.

Fjala “xhihad” përmendet në burimet bazë të Islamit: Kuran dhe Sunet (traditën profetike), por jo ekskluzivisht në kuptim të luftës, dhe as në kuptim të vrasjes apo terrorizimit, por aludon në luftë mbrojtëse kundër atyre të cilët i sulmojnë vendet dhe popujt e lirë dhe kanë qëllime pushtuese kolonialiste. Me fjalë tjera, xhihadi zhvillohet kundër agresorit.

Xhihadi ka edhe kuptim të luftës, kur kjo luftë shpallet për garantimin e lirisë së besimit dhe të drejtave të njeriut. Me fjalë tjera, nëse të drejtat themelore njerëzore nuk u garantohen njerëzve në një shtet, është e lejuar që të shpallet luftë me qëllim që njerëzit të çlirohen nga pushteti i tillë tiran dhe totalitar. Mirëpo, kjo luftë nuk bëhet që njerëzit të bëhen muslimanë, por lufta bëhet që t’u garantohet të gjithë njerëzve liria e besimit dhe të drejtat e tyre njerëzore. Këtë qartë e potencon edhe Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime në vendimin nr. 45, ku shënon si vijon: “Prej kuptimeve dhe formave të

¹³ Roy, Olivier, *Globalizimi i Islamit*, IDK, Tiranë, 2004, f. 189.

¹⁴ Karadavi, Jusuf, *Mesazhi ynë në epokën e globalizmit*, Furkan ISM, Shkup, 2011, f. 241.

xhihadit është edhe xhihadi në fushëbetejë, i cili xhihad në Kuranin famëlartë shprehet me nocionin “luftë”. Kjo luftë, apo kjo formë e xhihadit, është legalizuar për ta mbrojtur veten dhe për t’i rezistuar agresorit i cili të sulmon...Po ashtu, juristët islamë kanë arritur konsensus për legjitimitetin e xhihadit për t’iu kundërvënë formave të ndryshme të dhunës dhe shtypjes, siç është, fjala vjen, dhuna e njohur si “spastrim etnik”, pastaj xhihadi është legjitim edhe për t’iu kundërvënë okupimit të trojeve nga tjerët, pastaj për ta evituar dhunën fetare, etj...Ky lloj xhihadi është në lidhje të ngushtë me të drejtat legjitime njerëzore, në veçanti në kohën tonë. Në të dy rastet kemi rezistencë ndaj agresionit dhe ndalim të shtypjes dhe dhunës ndaj njerëzve. Aksionet militare janë opsioni i fundit, pasi të jenë të shterur të gjitha mekanizmat paqësor”.¹⁵

Nga ajo që u tha deri më tash, shihet qartë se nocioni “xhihad”, sipas burimeve fetare, nuk është përdorur vetëm në kontekst të luftës, edhe pse edhe lufta është një nga aspektet e xhihadit, por, xhihadi ka më tepër dimensione dhe është jo e drejtë, si në aspektin etimologjik, ashtu edhe në atë fetar, që xhihadi të kufizohet vetëm në veprimet militare.

5. Ndalimi për muslimanin që i pari t’i përshëndes me “selam” hebrejtë dhe të krishterët

Karakteri paqësor i Islamit u kontestua nga disa palë duke u thirrur në një thënie të të Dërguarit të Zotit, Muhamedit, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, ku tekstualisht qëndron se muslimani e ka të ndaluar që i pari t’i përshëndes me “selam” hebrejtë dhe të krishterët, si dhe i urdhëron që ata t’i detyrojnë të ecin skajeve të rrugës dhe në rrugë të ngushta, e jo në rrugë të gjëra dhe në mes të rrugës. Në hadith tekstualisht thuhet: “Mos i përshëndesni ju të parët, as hebrejtë dhe as të krishterët. Kur të takoni ndonjë nga ata në rrugë, detyroni të ec rrugicës më të ngushtë”.¹⁶

Ky hadith ka të bëjë me një ngjarje të caktuar, i referohet një ndodhie konkrete dhe është thënë në kontekst të veçantë. Kjo do të thotë se ky hadith nuk i referohet çdo situatë dhe nuk mund të merret si parim i përgjithshëm jashtë kontekstit të cilit i referohet. Hadithi ka të bëjë me ndodhinë e fisit Beni Kurejdha, kur muslimanët u nisën te ky fis, pasi tradhtoi dhe e shkeli marrëveshjen dhe besën që ia kishte dhënë të Dërguarit të Zotit, duke kaluar në anën e idhujtarëve kundër muslimanëve, tradhti kjo që dukej të ishte me

¹⁵ Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, *Vendimet dhe Fetvatë e publikuara nga themelimi, e deri në vitin 2017*, Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion, Lozanë, 2021, f.80-81.

¹⁶ Hadithin e ka transmetuar Muslimi në *Sahih-un* e tij, libri i xhihadit dhe ekspeditave, kapitulli: Për lutjen e të Dërguarit të Allahut drejtuar Allahut të Madhërishtëm, dhe për durimin e tij ndaj ofendimeve të munafikëve. Shih: En Nevevij, op. cit., vëll. XIV, f. 178. Hadithin e kanë transmetuar edhe koleksionues të tjerë të haditheve.

pasoja tejet negative për bashkësinë muslimane. Në atë rast, i Dërguari i Allahut iu drejtua shokëve të tij që e shoqëronin me këtë instruksion.¹⁷

Nisur nga kjo, Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, mban qëndrimin se lejohet që të përshëndeten jomuslimanët në përgjithësi me “esselamu alejkum”.¹⁸

Conclusions

Certain religious texts, both from the Qur'an and the Sunnah, have been used by certain parties and speakers to oppose the peaceful character of Islam.

One of the most obvious dilemmas in this regard is related to a chapter of the Qur'an, namely the chapter At Tawbah, which chapter, due to the content of some of its verses, is considered the chapter of war. According to those who dispute the peaceful character of Islam, the chapter At Tawbah is the most blatant example of the non-peaceful character of Islam.

The chapter At Tawbah talks about war, but not as a priority of the Muslim community and the determination of the Islamic religion for its members in relation to other communities and in international relations in general, but as a response to betrayals, obstacles, serious endangerment of the existence of Muslims, not respecting the rights of Muslims to choose the religion they want to belong to, depriving them of basic freedoms, banning free speech and freedom of thought, as well as because of their attack against Muslims.

Some have been called to a position of classical Islamic jurists, which has been followed by some other later jurists, that the leader of the Muslims, namely the head of the state, according to today's vocabulary, is obliged to send to the countries where non-Muslims live, every year, an army which will wage jihad (to be confronted militarily).

This issue has been treated by classical Islamic jurists, but the treatment of this issue has not been the result of the existence of religious texts that obligate or order such an action, nor has it been a position accepted by consensus by Islamic scholars, but it has been the result of the existing reality in their time.

In the wake of the disputes about the peaceful character of Islam and religious texts, some hadiths are highlighted which textually state that the Messenger of God was ordered to fight people until they say: "There is no god but Allah".

The answer to this dilemma is that the notion of people mentioned in the hadith, in no way refers to all of humanity, but to a certain group who were at war with the Muslim community at the time of the Messenger of God.

¹⁷ Shih: Rida, Muhamed Reshid, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-hakim (Tefsiru-l-menar)*, botimi i parë, Matba'atul menar, Egjipt, 1328h, vëll.V, fq.315.

¹⁸ Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, op. cit., f.295.

Fighting refers to those who fought the Muslims, not any party that was not part of the Islamic religion.

The concept of peace in Islam faced fierce debate from its opponents because of the institution of jihad, which, according to opponents of the peaceful character of Islam as a religion, was described by many parties as an inspiration for terrorism and incompatible with peace.

The definition of jihad as a notion which exclusively refers to war in the name of God, in order to make all people Muslim, is a mistake, since jihad has a much wider meaning than just war.

The peaceful character of Islam was contested by some parties calling for a ban on the first Muslim to greet Jews and Christians with "salaam".

This prohibition that is mentioned in the hadith has to do with a certain event, it refers to a concrete occurrence and it was said in a special context. This means that this hadith does not refer to every situation and cannot be taken as a general principle outside the context to which it refers.

Literatura

Abadi, Muhamed Shemsul Hakk El Adhim, *Aunul ma'ëbud sherhu Suneni Ebi Davud*, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1995.

Abu Sulejman, Abdulhamid, *Drejt një teorie islame për marrëdhëniet ndërkombëtare*, Logos-A, Shkup, 1998.

(El) Askalani, Ahmed ibn Ali ibn Haxher, *Fet'hul Bari bi sherhi Sahihil Buhari*, Daru Er Rejjan litturath, Kajro, 1988.

Bulaç, Ali, *Koncepte dhe sisteme bashkëkohore*, Logos-A, Shkup, 2005.

Ebu Zehra, Muhammed, *Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam*, përkthyes: Mervan Jakupi, Furkan ISM, Shkup, 2013.

Esposito, John L., *Fjalor i Oksfordit për Islamin*, përktheu nga anglishtja: Mimoza Sinani, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2017.

Gazali, Muhamed, *Komenti tematik i Kur'anit famëlartë*, përktheu: Sadush Tahiri, Logos-A, Shkup, 2007.

Ibn Ashur, Muhamed Et Tahir, *Tefsiru et tahriri ve et tenvir*, Ed Dar et tunisijje li en neshër, Tunis, 1984,

Ibn Kethir, Ismail ibn Omer, *Tefsirul Kur'anil adhim*, botimi i dytë, Daru Tajbe, Rijad, 1999.

Ibn Tejmijje, Tekijuddin Ahmed ibnu Abdil Halim ibn Abdisselam En Numjeri El Harani, *Mexhmu'ul fetava*, botimi i parë i kopjuar, Metabiu daril arebijje, Bejrut, 1398h,

El Karadavi, Jusuf, *Fetava muasire-IV*, botimi i parë, Darul kalem, Kajro-Kuvajt, 2009.

Kardavi, Jusuf, Mesazhi ynë në epokën e Globalizmit, përktheu nga arabishtja: Flori Kola, Furkan ISM, Shkup, 2011.

Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime, *Vendimet dhe Fetvatë e publikuara nga themelimi, e deri në vitin 2017*, përktheu nga arabishtja: Bashkim Aliu, Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion, Lozanë, 2021.

Kutub, Sejjid, *Islami dhe paqja universale*, përktheu nga anglishtja: Agim Mullafetahu, Asr, Tetovë, 2005.

Lashin, Musa Shahin, *Fet-hul mun'im sherhu Sahihi Muslim*, botimi i parë, Daru esh shuruk, Kajro, 2002.

En Nevevij, Jahja ibn Sheref, *El Minhaxh fi sherhi Sahihi Muslim ibn El Haxhxhaxh*, botimi i parë, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1995.

Rida, Muhamed Reshid, *Tefsiru-l-Kur'ani-l-hakim (Tefsiru-l-menar)*, botimi i parë, Matba'atul menar, Egjipt, 1328h.

El Xheuzijje, Muhamed ibn Ebi Bekër ibn Kajjim, *Ahkamu ehli dhimme*, botimi i parë, Remadi li en neshër, Demam, 1997.